

Shqipja standarde dhe modernizimi i saj

Konteksti ku funksionon shqipja standarde sot është i ri dhe shumë më i gjerë se dje. Ballafaqimi i kulturës shqiptare me kultura të tjera ka vënë para saj sprovën e vetëqëndrueshmërisë, në të vërtetë ndikimi i drejtpërdrejtë i gjuhëve e i kulturave të fuqishme për të paraqet sfida të madhe, në rend të parë për leksikun e saj. Pasurimi i leksikut sot paraqitet si njëri ndër problemet kryesore të saj dhe parakupton edhe modernizimin e saj. Ky modernizim duhet të jetë më i madh dhe duhet të jetë i “drejtuar”. Shqipja standarde duhet të modernizohet sepse dhe vetë shqiptarët e shoqëria shqiptare në përgjithësi po modernizohen. Duke qenë ose duke synuar të jetë gjuhë e një kulture të hapur, ajo, duhet të gjejë mënyrat si t’i bëjë ballë kësaj sfide, në të vërtetë, si ta ruajë *identitetin* e saj. Bota moderne, qytetërimi evropian, edhe ndër shqiptarët, hyn përmes gjuhës, përmes elementeve të gjuhës, përmes leksikut të saj.

A ka shqipja mundësi për t’iu përgjigjur si duhet ballafaqimit me kultura e gjuhë të tjera, a ka mundësi t’i qëndrojë kësaj hapjeje kulturore, këtyre bashkëmarrëdhënieve dhe këtyre ndikimeve e trysnive gjithnjë e më të mëdha nga jashtë?

Nuk janë të rralla shkrimet në të cilat shqipja standarde trajtohet si “e paaftë” dhe “e varfër” me mundësitë dhe mjetet për t’i bërë ballë kontekstit të ri socio-linguistik

Nëse është shqipja kaq “e pafuqishme”, kaq “e varfër”, kaq “e brishtë” si mund të shpjegohet fakti se ajo ka mbijetuar deri sot, edhe pse gjuhë e popullit me një histori aspak favorizuese përgjatë shekujve. Ata që sjellin këso argumentesh harrojnë se gjuha nuk është ajo që është, po ajo që mund të bëhet, që mund të gatitet. Dhe shqipja i ka të gjitha mundësitë për t’u bërë, për t’u gatitur e për të përballuar kohën e re, sepse siç na e thotë Eduard Sapiri “përmbajtja e çdo kulture mund të shprehet me gjuhën e saj”, ndërsa “përvojat e reja kulturore shpesh detyrojnë zgjerimin e mjeteve që ka një gjuhë.”

Ndikimet midis gjuhëve janë të vjetra sa edhe gjuhët. Dhe në kontekstin e këtyre ndikimeve shqipja ka mbijetuar. Pjesa më e hapur dhe më e ndikueshme prej trysnive brenda e jashtëgjuhësore është leksiku dhe ndryshimet shoqërore së pari shihen në leksikun, domethënë në fjalorin e saj. Dhe kjo ka ndodhur në shqipen si edhe në gjuhët e tjera. Më rrallë ndikimet dhe huazimet shihen në elementet gramatikore, sepse shqiptimi dhe gramatika janë sisteme të mbyllura dhe me vështirësi pranojnë elemente të

huaja. Dallimet midis leksikut të sotëm dhe leksikut të periudhave të mëhershme e provojnë këtë qartë. Në shqipen e sotme shtresa leksikore me burim të huaj ka përcaktues të ndryshëm kohorë. Brenda kësaj shtrese përdalloymë: fjalët e huaja, fjalët e ashtuquajtura *kalke a përkthime* dhe fjalët e krijuara nën ndikimin e gjuhëve të huaja - gjedheve të huaja. Edhe shqipja si gjuhët e tjera i pranon elementet e huaja leksikore, i përkthen, i përshtat, i asimilon dhe krijon neologjizma mbi bazën e tyre, domethënë aktivizon mekanizmat e vet për të përmbushur nevojat e veta. Dhe kjo po ndodh edhe sot kur në shqipen si asnjëherë tjetër në jetën e saj hyjnë ide, koncepte, nocione e terma nga gjuhë e kultura të ndryshme sidomos nga ato me ndikim të madh në proceset globalizuese. Sot në shqipen më së shumti hyjnë anglicizma. Por, përmes anglishtes nuk na vijnë vetëm fjalët burimore të anglishtes, por edhe fjalët që anglishtja i ka marrë nga gjuhë të ndryshme të Evropës dhe botës, edhe nga vendet e quajtura ekzotike si fjala vjen Azia, Afrika, Australia, Amerika e para Kolombos, Amerika Jugore, të cilat janë përshtatur së pari në anglishten duke u bërë pjesë e fjalorit të saj si *jogë, tajfun, gejshtë* etj.). Në shqipen ato duhet të konsiderohen si anglicizma, pavarësisht se nga e kanë burimin. Numër i konsiderueshëm i këtyre njësive leksikore duhet të konsiderohen ndërkombëtarizma dhe për to shqipja standarde është e hapur.

Në shoqërinë shqiptare kanë ndodhur ndryshime të mëdha në dy dhjetëvjetëshat e fundit. Në shumicën e ndryshimeve në shoqëri kanë ndikuar ndryshimet politike, kalimi prej një sistemi shtetëror e politik në tjetrin, organizimi i sistemeve e bashkësive të reja politike e shtetërore. Këto ndryshime u reflektuan edhe në gjuhën. Në shoqërinë shqiptare erdhën edhe ndikime të reja për çka ajo u detyrua të kërkojë gjedhe në shoqërinë sidomos perëndimore duke u përpjekur të formësohet e të zhvillohet sipas modeleve të veta. Dhe këto ndryshime u bënë burim dhe nxitje për zhvillime të reja edhe në gjuhë. Pikërisht pse leksiku është sistemi më i hapur dhe pse ndryshimet janë më të qartat aty, është me interes të hulumtohen ndryshimet që kanë ndodhur në këta dy dhjetëvjeçarë, për të parë shkallën e pasurimit të leksikut të shqipes, po edhe shkallën e modernizimit të tij. Një hulumtim i tillë mund të realizohet duke bërë krahasimin e korpusit leksikor të viteve '70 me korpusin leksikor të dhjetëvjetëshit të fundit. Teknologjitë informatike mundësojnë që me lehtësi të krijohen këto korpuse e të realizohen analiza të vlefshme. Për vitet '70 do të mund të merreshin si lëndë hulumtimi gazetat ditore që janë botuar në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni si *Zëri i Popullit, Rilindja* dhe *Flaka e vëllazërimit*. Për dhjetë vitet e fundit do të mund të merreshin disa nga gazetat kryesore ditore që botohen në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni. Edhe një analizë e thjeshtë e

këtyre gazetave do të zbulonte përfushë se cili është dallimi në leksik, në sasi e në cilësi, midis këtyre dy periudhave të zgjedhura për analiza. Hulumtimi nuk do të zbulonte vetëm shpërpjesëtimin në numra të njëjësive leksikore, sintagmave e frazeologjive librore, po edhe pasurimin me fjalë, shprehje e ndërtime të reja gjatë këtyre pak vjetëve. Do të ndriçohej, po kështu, edhe hyrja e fjalëve dhe e sintagmave të huaja, burimet nga vijnë ato dhe krijimi i neologjizmave mbi bazën e tyre. Do të hetoheshin edhe mënyrat e mjetet më produktive të fjalëformimeve të reja. Një analizë e tillë në të vërtetë do të zbulonte cilat janë rrugët e pasurimit të shqipes, cila është shkalla e modernizimit të shqipes dhe cila është masa e shfityrimit të shqipes nga elementet e huaja. Për një analizë të tillë gazetave ditore paraqesin një lëndë shumë të pasur e të larmishme tematike dhe një burim të gjerë informacioni qoftë edhe pse ato kanë funksione të ndryshme: informative, propaganduese, popullarizuese, edukuese, argëtuese etj.; informojnë për ngjarjet e reja e të shkuara, për shoqërinë, politikën, ekonominë, arsimin, kulturën, e të tjera. Nga analiza do të dalë se shumë njësi leksikore të viteve '70 sidomos fjalë me burim të huaj, tashmë konsiderohen njësi pasive të gjuhës, si p.sh. *klasë punëtore, vetëqeverisje, kontroll shoqëror, antagonizëm, lidhja socialiste, imperializëm*, etj.; se shumë njësi të tjera kanë zgjeruar fushën e tyre të përdorimit: *afirmim, pluralizim, delegim, devalvim, uzurpim, transparencë, korrupcion, liri të njeriut, demokraci, riintegrim, stabilitet* etj.; se shumë njësi kanë ngushtuar ose zgjeruar kuptimet: *aplikacion, debitant, performancë, korporatë* etj.; dhe se shumë të tjera janë krijuar në mbështetje të fjalëve e gjedheve ekzistuese: *totalitaritet, partneritet, multinacionalizëm, partikularizëm, supervizion, auditim, globalizoj*, etj.

Edhe me një vëzhgim sipërfaqësor në këtë lëndë gjuhësore do të mund të hetonim se numri i anglicizmave është dukshëm më i madh në vitet 2000 se në vitet '70 të shekullit të kaluar dhe se shumicën nga këto nuk i gjejmë në leksikun e viteve '70 si fjala vjen: *luk, bend, bodi, bos, kesh, fanki, doping, hard disk, xhinse, laptop, link, live, lobist, party, roler*, etj.; se numri i ndërkombëtarizmave është dukshëm më i madh, sidomos i atyre me burim latin: *fondacion, destinacion, klientelë, konzorcium, mandat, mobil, aplikacion, koalicion* etj.; se leksiku abstrakt e konkret është shumë më i gjerë dhe shumë më i larmishëm.

I madh është edhe numri i anglicizmave që nuk u gjendet lehtë prejardhja ose numri i përkthimeve në mbështetje të anglicizmave ose gjuhëve të tjera. Si këto: *attachment, chat billboard, bluetooth, bookmark, boyband, site, browser, fashion, network, reality show*, etj.

Edhe frekuenca e përdorimit të tyre është shumë e lartë. Mund të thuhet se prania e leksikut të huaj është e dukshme midis dy periudhave, edhe pse me largesë të vogël kohore mes vete. Në dhjetë vjetët e fundit numri i fjalëve të huaja në fjalorin e shqipes është shumë më i madh dhe kjo prani kaq e madhe, sidomos e anglicizmave, mund t'i "vishet" edhe globalizimit.

Anglicizmat nuk përshtaten lehtë në shqipen, në sistemin morfologjik të saj, sidomos në sistemin e lakimit, por as në strukturat sintaksore, ndërsa problem më vete paraqet drejtshkrimi i tyre. Në këtë kontekst gjuhësisë shqiptare i bie detyrë të hartojë një politikë gjuhësore reale e të zbatueshme.

Por, nuk është vetëm ndikimi i anglishtes problem për shqipen standarde. Edhe ndikimi i italishtes, sidomos përmes mjeteve të informimit, në Shqipëri dhe ndikimi i gjatë i serbishtes në Kosovë, paraqesin aspekt të rëndësishëm në analizat e korpusit gjuhësor të shqipes standarde.

Sipas studiuesve të kësaj fushe, fjalët e huaja nuk e rrezikojnë korpusin e gjuhës marrëse. Lënda e re gjuhësore, e huaj ose vendëse, në rast se integrohet në sistem ose pranohet si element i vlefshëm që ndihmon të kuptuarit ose komunikimin, në asnjë aspekt nuk mund të jetë i dëmshëm. Përkundrazi, në rast se ndihmon komunikimin gjuhësor dhe në rast se nuk prish veçoritë themelore të sistemit gjuhësor, paraqet element të rëndësishëm të pasurimit të gjuhës, i shërben zhvillimit gjuhësor.

Prandaj, dukuria e huazimit të fjalëve nga gjuhët e huaja si veçori e çdo gjuhe të qytetërimeve të zhvilluara duhet të konsiderohet mjet pasurues i gjuhës, sepse zgjeron mundësitë e saj shprehëse. Duke pasur parasysh kërkesat e shtuara të komunikimit gjuhësor, sidomos sot në kushtet e një zhvillimi kaq të madh shpirtëror e material të qytetërimit modern, duhet ta kemi të qartë se kërkesat e gjuhës nuk mund të plotësohen vetëm nga rezervat e brendshme. Nevojat e shtuara gjuhësore të shoqërisë shqiptare nuk mund të plotësohen nga burimet e shqipes, nga baza popullore e nga potenciali dialektor, megjithëse dialektet mbeten burim nga mund të merren elemente të ndryshme leksikore e gjedhe të krijimtarisë gjuhësore.

Fjalët e huaja duhet të kenë vendin e vet në gjuhë, në stilet funksionale: terminologji, politikë, administratë, shkencë, teknikë, ekonomi, etj. Kjo vlen edhe për fjalët e huaja që kanë hyrë më herët në shqipen. Fjalët e huaja duhet të përjetohen si përbërës të natyrshëm të gjuhës, sidomos fjalët që kanë veçori terminologjike. Nuk është e mundur të përkthejmë ose të kalkojmë çdo fjalë a shprehje të huaj dhe as nuk do të ishte punë e mire, sepse nuk mund të zëvendësohet secila fjalë e huaj me përgjegjësen në shqipen, shpesh as ajo që mund t'i gjendet përgjegjësja vendëse. Kështu për shembull leksema *porosi* nuk mbulon semantikisht plotësisht leksemën

mesazh, ashtu siç *modern* nuk do të thotë *bashkëkohor*. Me rastin e zëvendësimit të fjalëve të huaja me të shqipes duhet të kemi parasysh faktin se zgjerimi kaq i madh i dijeve shkencore kërkon jo vetëm shënjimin sa më të hollë semantik të nocioneve, koncepteve, ideve e përmbajtjeve, po edhe shpjegimin e tyre shumë të hollë.

Modernizimin e shqipes, pra, duhet parë edhe përmes pranimin të fjalëve të huaja, për të cilat, pa dyshim, ka nevojë shqipja standarde dhe për të cilat duhet të ketë një planifikim a një politikë gjuhësore.

*Rev. Gjuha shqipe (I. Albanologjik), 3/2008